



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORI

Nr. 1704/12 Prot.

Tiranë, më 02.12 2021

V E N D I M

Nr. 231 dt. 02.12 2021

**PËR RISHPALLJEN E KONKURSIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI,  
PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME "ASISTENT LEKTOR" NË  
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË  
SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanatit të FSHR me nr. 1704/1 prot., datë 02.12.2021 " *Kërkesë për rihapje konkursi*", Rektori,

V E N D O S I :

Rishpalljen në *web-in* [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

**I. DEPARTAMENTI I DISIPLINAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE**

**1. Shkenca Humane dhe Sociale (Mod. Bioetikë) "Bachelor" 1 (një) As/Lektor**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për As/Lektor, në lëndën: "Shkenca Humane dhe Sociale, (Moduli: Bioetikë), në Departamentin e Disiplinave Biomjekësore dhe Humane janë si më poshtë:

**Kritere të përgjithshme:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati që konkuron për pozicionin e punës "As/Lektor" duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e

kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);

3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8 (tetë).
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Të mos ketë cënuar ose prishur imazhin e UST-së.
6. Dëshmi Penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

#### **Kritere specifike :**

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Mjekësisë, me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
4. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së mjekësisë.
5. Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

#### **Kritere preferenciale:**

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e mjekësisë.

## **II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon;
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues);
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

### III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

### V. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

- VI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VII. Deri në datën 13.12.2021, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 15.12.2021 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- VIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- IX. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 17.12.2021, për miratim në Rektorat.
- X. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORATI

Prof. Dr. Agron KAS

